


REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
MUNICIPALITY OF GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Datë: 22.07.2022, Gjiçan

Bazuar, në Nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtaret Publik të Republikës së Kosovës Nr.06/L-114, Ligjin për Institucionet e Kulturës, Nr. 02/L-57, Ligjin për Teatrot, Nr. 04/L - 106 dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07 /2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Gjiçanit shpall:

#### **SHPLLJE E REKRUTIMIT**

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	<b>Drejtor i Teatrit të Qytetit</b>
<b>Institucioni:</b>	Komuna e Gjiçanit
<b>Departamenti/ Drejtoria:</b>	Drejtoria për kulturë, rini dhe sport
<b>Lloji i pozitës:</b>	Nëpunës i shërbimit publik
<b>Numri i pozitave:</b>	(1) një
<b>Titulli i mbikëqyresit:</b>	Drejtori i DKRS
<b>Grada/Kofeficienti:</b>	9.5
<b>Lloji i emërimit:</b>	Me mandat

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- bën menaxhimin financiar, administrativ, teknik dhe promovues të teatrit;
- zbaton vendimet e Këshillit drejtues të teatrit;
- propozon organizimin e brendshëm të teatrit tek Këshilli drejtues;
- përfaqëson teatrin brenda dhe jashtë vendit;
- propozon buxhetin vjetor para Këshillit drejtues;
- kërkon, aplikon dhe negocion për marrjen e donacioneve;
- mbikëqyrë të hyrat dhe shpenzimet buxhetore si dhe të donacioneve;
- negocion dhe nënshkruan kontratat dhe marrëveshjet me artistë të pavarur dhe me palë tjera;
- menaxhon mirëmbajtjen dhe sigurimin e ndërtesës së teatrit;
- menaxhon bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;;
- për punën e tij i përgjigjet Këshillit drejtues të teatrit;
- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe statut të teatrit;

**Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publik;**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse,
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale me dashje,
- Të mos ketë në fuqi ndonjë masë disiplinore për largim nga pozita e zyrtarit publik

**Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

- Diplomë universiteti nga fusha e teatrit ose lëmi të përafërta të kulturës;
- Të ketë 5 vite përvojë pune profesionale;
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me ligjin për gjuhët,
- Njohuri të punës me kompjuter, Word, Excel, power point, etj;
- Të ketë shkathtësi të mira menaxhuese, komunikuese dhe ndër njerëzore dhe të jetë i gatshëm të punoj me orar fleksibil të punës dhe në grupe;
- Të ketë aftësi të mira për ruajtjen dhe zhvillimin e kontakteve brenda dhe jashtë teatrit.

**Rregullimi i mandatit:** bazuar në nenin 13 paragrafi 3 të Ligjit për Teatrot nr. 04/L-106, mandati i Drejtorit të përgjithshëm të teatrit është 4 (katër) vite me mundësi rizgjedhjeje.

**Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartcekur duhet t'i kompletoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (fotokopje) si vijon:**

1. Dëshmi të kualifikimit shkollorë, fotokopje e noterizuar (Nëse kandidati ka të mbaruar shkollimin jashtë shtetit, diploma duhet të jetë e nostrifikuar nga MASHT)
2. Dëshmi mbi përvojën e punës
3. Dokumentin e identifikimit
4. Çertifikatën se nuk është nën hetime

**Procedura e konkurrimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar**

Komuna e Gjilanit i ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe i mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë drejtë përfaqësim proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike si në nivel qendror njashtu edhe atë lokal

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 22.08.2022 deri me 05.09.2022.**

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në arkivin qendror të Komunës së Gjilanit, përkatësisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të njoftohen për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së testimit me shkrim përmes Ueb faqes zyrtare të komunës dhe tabelës së shpalljeve publike të Komunës.

Dokumentet e fotokopjuara mund të tërhiqen në afat prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të procedurës konkurruese, pas këtij afati të njëjtat nuk kthehen.

Rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>